

**ALFRED ÇAPALIKU****TRASHËGIMIA LETRARE E VELI STAFËS**

Në dy vitet e fundit në Kolegjin Saverian të Shkodrës (1931-1933), ku mësues të gjuhës shqipe dhe të retorikës pati poetin Ndre Mjeda, rioshi Veli Stafa e ndjeu veten të prirur nga vjershat. Këputi një trëndafil të bardhë dhe duke e çuar te buzët e puthi lehtë. Por shpejt studenti Veli Stafa u bë mendimtar në prozë, meqë ndjente nevojën e paradokseve. Në lëmën fantazmagorike të tipave e karaktereve në vendin e tij të vogël, tastiera e gjerë e shpirtit iu prek tash e parë nga dashuria e madhe, shoqëruar me dhimbje të thellë. Në tetë vite krijimtarie që hapen në shkollën e Shkodrës, vazhdojnë në universitetin e Bolonjës dhe mbylleen në sanatoriumin e Parisit, Platonicus i shkroi mbi njëzet poezi, mbi njëzet proza të shkurtra e mbi dhjetë lloje shkrimesh të publicistikës letrare. Pjesën më të madhe të tyre ai e botoi në revistat e gazetat: “Bota e Re” të Korçës dhe “Java”, “Përpyjekja shqiptare”, “Minerva”, “Illyria”, “Arbënia”, “Populli”, “Shtypi”, “Shekulli XX”, etj. të Tiranës. Letërsia dhe gazetaria letrare e tij ngërthen mbi njëqind e gjashtëdhjetë faqe. Vjershat, tregimet, artikujt e patën receptimin e tyre normal përgjatë shtrirjes së dekadës së katërt të shekullit XX. Në dekadat e mëpasme vazhdoi jehona e kritikës ndaj atij opusi. Dorëshkrimet e Platonicusit, që u bënë të njohura në vitin 1982 në Tiranë me botimin pothuajse të plotë të veprës së tij letrare nga studiuesi Andrea Varfi, flasin për shijen e hollë të shkrimtarit të ri gjatë publikimit dhe përgjatë rezervimit, duke e përzgjedhur me kujdes krijimtarinë nëpërmjet kapërcimit stilistik të vetvetes. E sipërfaqshmja e një çasti bëhej e thellë në një çast tjetër. Krijimtaria e mbetur në “sirtar” dëshmon gjithashtu për kohën fizike aq të paktë e krejt të pamjaftueshme, që Veli Stafa jetëshkurtër pati në dispozicion për ta botuar komplet veprën e tij letrare. Prodhimtaria mikse e promovuar e Platonicusit hyri denjësisht në garën reale, mes individualiteteve letrare të mirënjohura të viteve ’30, me tematikën e re origjinale dhe me finesën shprehëse të saj. Ajo që si një peshore ku matej ndjeshmëria njerëzore. Krijimet poetike me forma të ndryshme strofe e metri, me praninë e vargut të lirë, si dhe skicat, portretet, vizatimet letrare e tregimet e botuara në kolona gazetash bënë që ai të portretizohej në historinë e letërsisë shqipe, si një: “... poet dhe prozator i talentuar” (1).

Gjatë atyre tetë viteve, kur në skenën e artit të fjalës po interpretonte zëri tingëllues e origjinal i Veli Stafës, përndryshe kur firma Platonicus po hynte

normalisht në sistemin letrar të kohës përmes publikimit në gazeta dhe në revista, kultura shqiptare pati në qarkullim libra me peshë, vepra me nivele të larta artistike, modele me spikatje estetike. Shquajnë ndër botimet poetike: vëllimet e Vinçenc Prennushit “Gjeth e lule”, Shkodër 1931 (poezi), të Ernest Koliqit “Gjurmat e stinve”, Tiranë 1933 (poezi), të Lasgush Poradecit “Vallja e Yjve”, Kostancë 1933 (poezi) dhe të Filip Shirokës “Zani i zemrës”, Tiranë 1933 (poezi), të Vedat Kokonës “Dritë dhe hije”, Tiranë 1935 (poezi) dhe të Dhimitër S. Shuteriqit “Kangët e rinis së parë”, Korçë 1935 (poezi) e “Kangë?”, Korçë 1936 (poezi), si dhe të Migjenit “Vargje të lira”, Tiranë 1936 (poezi) e të Lasgush Poradecit “Ylli i zemrës”, Bukuresht 1936 (poezi), të Gjergj Fishtës “Lahuta e Malcis”, Shkodër 1937 (poemë epike historike), të Nexhat Hakiut “Këngët e zambares”, Tiranë 1939 (poezi) dhe të Etëhem Haxhiademit “Lyra”, Tiranë 1939 (poezi). Në të njëjtin hark kohor të dekadës së katërt të shekullit të njëzetë bien në sy për popullaritet e dallohen për cilësi artistike, ndër përmbledhjet me prozë të shkurtër: ato të Sterjo Spasses “Kunorë rinije”, Korçë 1934 (tregime) e “Në krahët e njëj femne”, Korçë 1934 (tregime), si dhe të Nonda Bulkës “Kur qan e qesh bilbili”, Korçë, 1934 (skica, tregime), të Ernest Koliqit “Tregtar flamujsh”, Tiranë, 1935 (tregime) dhe të Vedat Kokonës “Nga Tirana në Stockholm”, Tiranë, 1935 (ditar me shënime udhëtimi), të Milto Sotir Gurrës “Plagët e kurbetit”, Tiranë, 1938 (tregime) dhe të Mitrush Kutelit “Netë shqipëtare”, Bukuresht, 1938 (rrëfime), gjithashtu të Musine Kokalarit “Siç më thotë nënua plakë”, Tiranë, 1939 (tregime). Në këtë periudhë dallohen në prozën e gjatë përmbledhja dokumentare e Anton Harapit “Urti e burrni ndër banorë të Cemit”, Shkodër 1933 – 1935, romani i Sterjo Spasses “Nga jeta në jetë - Pse!?” , Korçë 1936 dhe ai i Haki Stërmillit “Sikur t’isha djalë”, Tiranë 1936. Në periudhën 1931-1939 spikasin lloje të ndryshme veprash dramatike, një pjesë e të cilave u luajtën në skenë nga trupat teatrale amatore, si tragjeditë e Etëhem Haxhiademit “Akili”, “Aleksandri”, “Ulisi”, Tiranë 1931, “Pirrua”, Tiranë 1934, “Skënderbeu”, Tiranë 1935, “Diomedi” Tiranë 1936, “Abeli”, Tiranë 1939, drama e Vinçenc Prennushit “Prej robnije në liri”, Shkodër 1931 e komedia e Gjergj Fishtës “I ligu për mend”, Shkodër 1931, komeditë e Andon Zako Çajupit: “Burr’ i dheut” dhe “Pas vdekjes”, Kajro 1937. Gjithashtu, gjatë atij segmenti të shkurtër, por mjaft të ndritshëm të shekullit të njëzetë pati mjaft botime cilësore në shtypin periodik, si poezitë erotike të Ali Asllanit, vjershat patriotike të Ndre Zadejës (D.N.Z.), lirikat meditative të Lazër Shantojës (Lilian), poemat filozofike të Bernardin Palajt (Kukel Lapaj), vargjet e lira të Gaspër Palit (Gimi), shkrimet memorialistike të Justin Rrotës (Iris), tregimet romantike të Kolë Mirditës (Helenau), novelat sentimentaliste të Injac Zamputtit (Ales), skicat realiste të Millosh Gjergj Nikollës (Migjeni), esetë kulturore të Ernest Koliqit (Erkol), ligjërimet poetike të Petro Markos (Demo – Koti) etj.; publikime të cilat u intonuan me regjistrat e tyre specifike në polifoninë e Letërsisë së Pavarësisë.

Trashëgimia letrare e Platonicusit nuk është e paraqitur grafikisht në gegërishten veriperëndimore të gropës së Shkodrës ku u shkollua, por në gegërishten normative të kohës, përmes gjuhës artistike të përdorur prej tij. Autori la për së gjalli krijimtarinë e shpërndarë në organet e shtypit të viteve '30 në kryeqytet dhe post mortum një libër me titullin: "Veli Stafa. Vepra letrare", botuar në Tiranë më 1982. Kjo i mjafton Veli Stafës të zërë vendin që i përket, sipas vlerës reale në tabelën e Mendelejevit të letërsisë shqipe, pranë Kolë Mirditës dhe Gaspër Palit. Arsyeya pse Platonicus na tingëllon i veçantë shpjegohet në një përgjithësim të studiuesit Ernest Koliqi: "*Pasunija letrare e nji kombit përmban shkrimtarë të mëdhenj dhe shkrimtarë dytanikë (ecrivains mineurs), të cilëve nuk u duhet mohue randësija. Shpesh në dytanikët, shpirti i mshehtët autokton shfaqet i vetvetishëm e i kulluet dhe na zbulon veti të panjoftuna të brumit tonë kombëtar.*" (2)

Krijimtaria mikse e Platonicusit tërhoqi vëmendjen e lexuesit të zakonshëm dhe interesimin e lexuesit intelektual, në harkun ylberor të viteve '30. Kjo arritje personale erdhi edhe në saje të jehonës që i kushtuan krijimtarisë së tij redaksitë e gazetave dhe të revistave të kohës. Prodhimtaria letrare e Platonicusit pati shqyrtim nga kritika letrare e kualifikuar e gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë. Gjithashtu vepra artistike e Veli Stafës u përfshi në lëndën e letërsisë shqipe të shkollave të mesme të përgjithshme dhe të arsimit të lartë pedagogjik në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë duke e popullarizuar kështu autorin. Poezitë dhe prozat e Platonicusit u shpjeguan e u komentuan nga mësuesit e letërsisë në shkollat e mesme të përgjithshme. Ato u interpretuan e u analizuan më hollësisht nga profesorët e profilizuar të lëndës në institute pedagogjike dhe në universitet. Ndërsa pas 1990-ës, ndonëse Veli Stafa vijoi të bëjë pjesë në programet e shkollës së lartë, vepra e tij e larmishme e plot trill, rezultoi me interferim kryesisht tek lexuesi i interesuar, filolog dhe nganjëherë tek ai kurioz. Në ditët tona krijimtaria e Veli Stafës me intensitet e preferencë ndiqet përgjithësisht nga lexuesi i zgjedhur, elitë. Duke analizuar fillimet e zhvillimit të letërsisë moderne shqiptare, studiuesi Sabri Hamiti nënvizon, se në atë periudhë ringjalljeje: "*kultivohet stili i ri letrar, si karakteristikë e krijuesve individualë... tematikat letrare dalin nga kupolat atdhetare dhe shfaqen në rrafshet shoqërore e të botës së brendshme individuale njerëzore.*" (3)

Këto veçori të spikatura të individualitetit artistik personalizohen në firmën Platonicus, por edhe përgjithësohen tek treshja e "poetëve të vdekur në rini" përmes cilësive estetike të shprehura qartë, gjatë leximit për herë të parë apo rileximit të vëmendshëm, midis vargjeve e midis rreshtave, të krijimeve më përfaqësuese të tre shkrimtarëve të rinj. Trashëgimia letrare e Veli Stafës duhet parë e lidhur ngushtë me horizontin e pritjes të veprës së shkrimtarit gjatë kohës së formimit të shtetit të ri e të pavarur shqiptar. Periudha nga viti 1912 gjer në vitin 1939, siç vëren studiuesi Stefan Çapaliku: "... pavarësisht nga

*mbetjet estetike romantike prej shekullit të kaluar, i hap shtigjet letërsisë moderne shqiptare. Dalëngadalë letërsia nis të harrojë çështjet e “mëdha”: nacionalizmi ... etj. dhe i kthehet njeriut, botës së tij të brendshme, psikës e deri dhe pavetdijes së tij ... kodet ligjërimore pasurohen me ato përshkruese, çka do të thotë se ka filluar letërsia e ashtuquajtur “realiste”.*” (4)

Brenda tetë viteve krijimtari Platonicus na la trashëgimi evoluimin e stilit individual.

Në poezinë esenciale të tij bie në sy kalimi nga motivet intime tek ato shoqërore. Heroi lirik i tyre njësohet me përjetimet e autorit duke e kthyer monologun personal në dialog me lexuesin. Kësisoj vargjet ia ruajnë profilin intim edhe atëherë kur Platonicus shkruan poezi sociale me refleksë angazhimi apo me nuanca qëllimore. Veli Stafa e parapëlqen simbolin si rrobe letrare jo për t’u fshehur, por për t’u shprehur. Ai realizon natyrshëm e pa sforcim një poezi shpirtërore të thellë, ku më tepër pëshpëritet, sesa flitet; ku më tepër ndihet se sa preket; ku më tepër nënkuptohet se sa shihet drejtpërdrejtë. Shtjella e poezisë së tij buron sentimentaliste, por rrjedh realiste. Hija e një heroine tragjike me emrin Mari parakalon nga poezia në prozë, nga përjetimi në nostalgji, duke e lënë autorin dukshëm në vetmi.

Në prozën e shkurtër të Platonicusit vihet re kalimi gradual nga vizatimet e çastit, nga portretet shprehëse, nga përshkrimet figurative e nga skicat poetike, tek tregimet realiste me fabula origjinale e të goditura, mjaft të spikatura e tepër përshtypjëlënëse. Pamjet prizmatike nga jeta e përditshme, duke u kombinuar me njëra-tjetrën, formojnë sfondin e plotë, ku lëvizin personazhet e shqetësuara apo ku fiksohen manekinët dhe marionetat statike. Alternimi i rrëfimit (shprehur në vetën e parë gramatikore të numrit njëjës), me rrëfenjën (artikulluar në vetën e tretë gramatikore të njëjësit e të shumësit), në prozën e shkurtër të Platonicusit luhetet vazhdimisht në kufirin lëvizës midis fakticitetit dhe fictionit. Rrjedha e prozës së tij që vërtitet më shumë rreth detajeve të përshkrimit, xhiron më shpesh tek monologu e sillet më rrallë tek dialogu. Një copë jete e prozës me ngjyra bardh e zi është pamje nga albumi i Shqipërisë gjatë viteve të Pavarësisë. Një copë jete e prozës me ngjyra kontrastuese është panoramë nga kuadri i Evropës para Luftës së Dytë Botërore.

Ndërsa në publicistikë duket që fakti i zgjedhur nga Platonicus apo ngjarja nga jeta e përditshme e trajtuar prej tij nuk e humb asnjëherë letraritetin, gjë që e bën të shndërrohet në motiv për poezinë sociale apo në subjekt për prozën e shkurtër me temë aktuale. Shkrimet problemore të Platonicusit të botuara në gazeta të përditshme, të përjavshme, dyjavore, apo në revista një - dy - tre mujore, e ruajnë të renë pafundësisht edhe mbas sa e sa vitesh përmes artit të paraqitjes. Publicistika e tij kap tiparet dhe sfumaturat e karaktereve njerëzore në monotoninë e një jete që duhej ndryshuar. Gazetaria i jepte Platonicusit kontaktin aq të dëshiruar për çdo autor të asaj kohe me publikun anonim apo me fansat ndjekës të firmës së tij. Sot ajo na paraqet shkallëzimin e stilit të

shkrimtarit kur merret me publicistikë, që dëshmon për ruajtjen e nivelit artistik të gjuhës.

Në poezi, në prozë dhe në gazetari letrare Platonicus shpërndante mesazhe dashurie për njerëz që vinin në botë, duke sjellë hijen e duke lënë gjurmën. Poezia, proza dhe publicistika i siguronte lexues, të paktën në një rën prej llojeve e zhanreve. Kështu ai promovonte firmën letrare. Pa arritur të bënte shkëputjen e madhe artistike si Migjeni, Platonicus mbijetoj me rritjen e termometrit të tij emocional. Ai u ndodh në dy realitete të ndryshme në Shqipëri e në Itali dhe i vështroi dy peizazhet njerëzore me syrin e mprehtë të shkrimtarit, që në poezi bëhet hero lirik dhe në prozë kthehet në personazh. Ai u kthye në medium për transformimin e dy roleve paralele: të doktorit dhe të pacientit. Ai u ndesh në dy kontraste të shpejta: me dashurinë dhe me vdekjen. Ai u gjend në dy tërheqje njëherësh: nga letërsia e nga mjekësia. Veli Stafa nuk u dyzua asnjëherë në personalitet, por u dozua vazhdimisht në sensibilitet. Në një moshë fare të re ai qe shumë i ditur. Ai qe njëri nga yjet intelektuale të kohës së tij. Platonicus u manifestua si shkrimtar mjaft shprehës jo veç në poezi e në prozë, por edhe në publicistikë e në ditarizëm. Korpusi i kompletuar na shërben edhe sot e kësaj dite si një traditë fort e çmuar. Kjo është e lidhur drejtpërdrejt me kënaqësinë e leximit të pjesëve më të mira të krijimtarisë letrare të Veli Stafës. Ja njëra prej tyre:

### **RREZE DRITORESH**

Një dritore, një grilë hieroglifike. Mbas grilës persiane dy sy të kulluet.  
Dy sy xhixhëllues nga ethet njëzetvjeçare.

Dy sy të lodhun nga shtrëngesa e prangave të zakonit.

Herë mbas here, nga katrorët e koklavitun të dritores dy sytë lëvizin.

Qepallat ulen e ngrihen, të shoqueme nga të fshamet e ndalueme të dëshirave ma të ndalueme.

Një rreze hane përshkon vjedhtas grilën orientale.

Shkëlqejnë krrelat e vashës së burgosun.

Shkëlqejnë dy kokrra lotësh, që rrëshqasin tinës mbi faqet e nxehta.

Dy sy! Dy kokrra lotësh mbas një dritareje aziatike.

Dy sy! Dy kokrra lotësh të puthun vetëm nga një rreze hane.

Andrron krijesa e burgosun? Tretet ndër kujtime të kalueme?

As andrron, as prehet në një jetë ma të bukur. Vuen në heshtje.

Në heshtje i nënshtrohet tragjedisës së vet e të sa e sa shoqeve të saj. E din se për t' u dukë vajzë e urtë, duhet të dijë me jetue si skllave.

Nga një radio e afërme një kitarë e lodhun dredh melodinë përqethëse të një muzike cigane.

3 shtator 1936.

P.S.

Veli Stafa u lind në Elbasan më 25.10.1915 dhe u shua në Paris më 18.03.1939. Në prag të përvjetorit të tetëdhjetë të ndarjes së tij nga jeta, po i sjell Platonicusit plot me devocion këtë peng nderimi.

Autori. Shkodër, 08.05.2018.

#### **REFERENCA**

Çapaliku, Stefan, *Ars albanica*. Përmbledhje studimesh. Tiranë, 2017, f. 20; 28.

Grup autorësh: *Historia e letërsisë shqiptare 1*. (Për shkollat e mesme të përgjithshme). Tiranë, 1993, f. 162.

Hamiti, Sabri, *Letërsia moderne. Vepra letrare 8*. Prishtinë, 2002, f. 17.

Koliqi, Ernest, *Zef M. Harapi, auctor rromanxash e dramash*. Kritikë dhe estetikë. Tiranë, 1999, f. 187.